



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT

MINISTRIA E FINANCËVE
MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTRY OF FINANCE

KKRF- KËSHILLI I KOSOVËS PËR RAPORTIM FINANCIAR
KSFI – KOSOVSKI SAVET ZA FINANCIJKO IZVEŠTAVANJE
KCFR – KOSOVO FINANCIAL REPORTING COUNCIL

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 02/2014

Zbatimi i SNRF-së për shoqëritë tregtare të mesme dhe të vogla

Ligji Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) i jep Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar (KKRF) autoritetin që të vendos regjimin për raportimin financiar të shoqërive tregtare në Kosovë, përfshirë certifikimin e kontabilistëve dhe licencimin e auditorëve.

Gjatë implementimit të dispozitave të Ligjit, Këshilli vështron standardet e aplikueshme ndërkombëtare, udhëzuesit dhe interpretimet e ndryshme, dhe përafron praktikën në Kosovë me Direktivat relevante 4, 7 dhe 8 të Ligjit Europian të kompanive.

Direktiva e 8 e BE “Mbi auditimet ligjore të pasqyrave financiare vjetore dhe pasqyrave të konsoliduara financiare” dhe Standardi 8 Ndërkombëtar i Edukimit “Kërkesat për kompetencë për profesionistët e auditimit” të publikuara nga Bordi për Standardet Ndërkombëtare të Edukimit për Kontabilitet (BSNEK-IAESB) janë të një rëndësie të veçantë për qëllimin e kësaj urdhërese administrative.

Neni 1.

Përkufizimet

SNK -Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin dhe prezentimin e transaksioneve dhe ngjarjeve të ndryshme kontabël në pasqyrat financiare.

